



## **Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA**

**MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS**

---

**Departamenti i Administratës Qendrore/Departament Centralne Administracije**

**Department of Central Administration**

**Divizioni i personelit / Divizija personela / Personnel division**

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/01, Ministria e Punëve të Brendshme, shpall:

### **KONKURS**

**Për plotësimin e vendit të lirë të punës**

#### **I. Titulli i punës: Drejtor i Departamentit për Siguri Publike**

**Departamenti:** Departamenti për Siguri Publike

**Kohëzgjatja e kontratës:** Sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil

**Koeficienti:** 10 (dhjetë)

**Orari i plotë:** Po

**Raporton tek:** Sekretari i Përhershëm i MPB

**Përgjegjësit mbikëqyrëse:** Po

**Vendi:** Prishtinë

#### **Funksionet e pozitës:**

Drejtori i DSP është përgjegjës për planifikim, drejtim, koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës dhe zyrtarëve të departamentit, në atë mënyrë që garanton përmbushjen e normave ligjore në fuqi, veçanërisht në fushat e rendit dhe sigurisë publike, detyrave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2010-MPB, Ligji mbi armët; Ligji për përdorimin civil të eksplozivëve, Ligji për aviacionin civil, etj;

## **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Menaxhimi i punës dhe zyrtarëve të Departamentit për Siguri Publike.
2. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në përgatitjen e planeve të punës dhe propozimet për buxhetin e DSP, delegimin e detyrave tek vartësit përkatës në pajtim me përshkrimin e vendeve të tyre të punës dhe nevojat e departamentit, si dhe vlerësimi vjetori i punës së të punësuarve;
3. Përgatiti rekomandime për Ministrin dhe Sekretarin Permanent për në fushën e sigurisë publike dhe vendosjen e prioriteteve të Ministrisë në këtë fushë;
4. Siguron bashkëpunim dhe ndihmë për Zyrën e Burimeve Njerëzore në Ministri për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me çështjet e Sigurisë Publike; si dhe me Zyrën për Komunikim në fushën e komunikimit dhe të informacionit lidhur me Sigurinë Publike;
5. Siguron koordinimin me ministritë dhe institucionet e tjera relevante;
6. Zhvillon dhe ekzekuton qëllimet strategjike duke përforcuar sigurinë publike me përqendrim të veçantë, por duke mos u kufizuar vetëm në kontrollin dhe monitorimin ndaj armëve, mjeteve shpërthyes, sigurimin e aviacionit civil, kompanitë private të sigurimit dhe sigurisë publike në përgjithësi;
7. Organizon dhe koordinon punën për të zhvilluar dhe për të publikuar konceptet e përgjithshme dhe udhëzimet për Policinë në Komunitet/Partneritetet shtetërore-private të sigurisë;
8. Organizon dhe koordinon punën për të mbledhur, sistemuar dhe për të analizuar të dhënat, si dhe mbajtjen e një baze të të dhënave të përditësuar; poashtu Organizon dhe koordinon punën për të kryer hulumtim të rregullt lidhur me kërcënimin ndaj sigurisë publike si dhe analizimi i opinionit publik lidhur me perceptimet ndaj sigurisë publike;
9. Kryen detyra të tjera lidhur me mandatin e departamentit:

## **Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:**

- Të komunikojë në mënyrë efektive dhe të rregullt me Sekretarin e Përhershëm dhe Ministrin sipas rregullave përkatëse;
- Të sigurojë komunikimin dhe koordinimin efektiv brenda departamentit dhe Ministrisë;
- Të delegojë detyrat tek të punësuarit përkatës për të bërë të mundur përdorimin më të mirë të aftësive dhe burimeve njerëzore
- Të negociojë në mënyrë intensive dhe efektive me zyrtarët kryesorë të institucioneve të Kosovës që kanë përgjegjësi të ndryshme në fushën e Sigurisë Publike;
- Të demonstrojë integritet profesional dhe etik në komunikimin me përfaqësuesit e agjencive ndërkombëtare në Kosovë;
- Të demonstrojë aftësi komunikimi dhe përfaqësimi me median dhe palët e interesuara;

## **Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

- Përvojë të mëparshme pune prej së paku 5 vitesh brenda institucioneve të Qeverisë së Kosovës ose organizatave ndërkombëtare në Kosovë veçanërisht në sektorin e sigurisë;
- Përvojë e konsiderueshme pune në menaxhimin e projekteve dhe koordinimin e punëve ndër-institucionale;
- Njohje të konsiderueshme të strategjive dhe programeve relevante të Qeverisë së Kosovës që lidhen me sektorin e sigurisë;
- Diplomë Fakulteti në një nga shkencat shoqërore;
- Trajnimet e specializuara në sektorin e sigurisë janë përparësi;
- Aftësi të shkëlqyer analitike dhe komunikimi;
- Aftësi të shkëlqyer në komunikim ndër-personal dhe aftësi për punë ekipore dhe nën presion;
- Njohuri të shumë të mirë të programeve kryesore të "Microsoft Office";
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhëve zyrtare;
- Njohja e gjuhës angleze është e domosdoshme;

## **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Formularët për aplikim mund të merren te porta e MPB-së, ose të tërhiqen nga **web** faqja e MPB-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën [www.mpb-ks.org](http://www.mpb-ks.org) dhe dorëzohen në Zyrën e Personelit, ose nëpërmjet postës, në adresën: **MPB – DAQ, Rr. Luan Haradinaj p.n (afër stadiumit)-Prishtinë**, çdo ditë punë nga ora **8:00 -16:00**.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni personelin, prej orës **8-16:00**, në tel **038 200 19 547**.

Konkursi mbetet i hapur **15** ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: kopja e letërnjoftimit, kopja e lejes së vozitjes, kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumentacionet tjera të nevojshme.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, nga personeli.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për shikim (konfirmim) të gjitha dokumentet origjinale.

**Ministria e Punëve të Brendshme i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ajo i mirëpret aplikacionet prej femrave dhe meshkujve të të gjitha grupeve etnike të Kosovës.**